

Këto efekte anësore të zakonshme janë shumë më pak serioze sesa zhvillimi i COVID-19 ose komplikimet që lidhen me COVID-19, dhe ato zakonisht largohen brenda pak ditësh. Ju mund të pushoni dhe të merrni Paracetamol për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.



NË CILAT RASTE NUK MERRET VAKSINA KUNDËR COVID-19?

Ka shumë pak njerëz që nuk mund të marrin vaksinën kundër COVID-19.

Vaksina nuk duhet t'u bëhet:

Personave që kanë pasur një **reaksion alergjik** të konfirmuar ndaj ndonjërit prej përbërësve të vaksinës


Ata që kanë pasur një **reaksion alergjik** të konfirmuar në një dozë të mëparshme të së njëjtës vaksinë COVID-19

Personat me histori të reaksioneve të rënda alergjike ndaj ushqimit, ndonjë medikamenti ose vaccine të identifikuar, ose një pickimi insekti, mund të vaksinohen me çdo vaksinë COVID-19, për sa kohë që nuk dihet të jetë alergjik ndaj çdo komponenti të vaksinës.



Është e rëndësishme që t'i tregoni personelit shëndetësor që ju bën vaksinën nëse keni patur ndonjëherë një reaksion alergjik serioz (anafilaksi).

MBRO VETEN nga COVID-19



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

unicef
for every child

Një pjesë e konsiderueshme e infeksioneve të **COVID-19** nuk shfaqin asnjë shenjë. Simptomat e zakonshme të COVID-19 janë:



Kollë e vazhdueshme



Ethe/temperaturë të lartë



Humbje e shijes ose të nuhatjes

COVID-19 mund të prekë **KËDO**.

Mund të shkaktojë sëmundje serioze, shtrime në spital dhe madje edhe vdekje.



Vaksina është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga COVID-19

Vaksina nuk shkakton COVID-19. Ajo të ndihmon për të forcuar imunitetin ndaj virusit, kështu që trupi juaj do ta luftojë më lehtë nëse ju prekeni. Kjo mund të zvogëlojë rrezikun tuaj për të zhvilluar COVID-19 ose, nëse sëmureni me COVID-19, mund t'i bëjë simptomat më të lehta.



KUSH DUHET TË VAKSINOHET?



TË GJITHË

Adultët mbi 18 vjeç duhet të vaksinohen ndaj COVID-19.

Adoleshentët 16-18 vjeç me miratimin e prindërve

Fëmijët 12-15 vjeç, nëse kanë sëmundje që ulin imunitetin dhe me miratimin e prindërve

GRATË SHTATZËNA, sepse:

o Kanë rrezik për forma të rënda COVID-19

o Mund të bëjnë lindje të parakohshme

o Mund të kenë probleme të tjera serioze për shëndetin e tyre dhe të foshnjës

CILAT JANË EFEKTET ANËSORE?



Si të gjitha medikamentet, edhe vaksinat kanë efekte anësore. Është normale të përjetoni efekte anësore pas vaksinimit. Ajo tregon se vaksina po mëson sistemin imunitar të trupit tuaj se si të mbrohet nga sëmundja. Sidoqoftë, jo të gjithë kanë efekte anësore dhe shumica e tyre janë simptoma të lehta dhe afatshkurtra.

Efektet anësore më të zakonshme shfaqen gjatë dy ditëve të para pas kryerjes së vaksinës dhe përfshijnë:



Dhimbje të krahut në vendin ku është bërë vaksina



Ndjenja e lodhjes



Dhimbje koke, trupi



Të përziera



Ethe për një ose dy ditë